




ALEANCA *per* SHQIPTARËT

PLATFORMA ZGJEDHORE

2016 - 2020



UNITETI

Përmbajtja

1. Hyrje	5
2. Kushtetuta	7
3. Marrëveshja e Ohrit	7
4. Ndarja e pushteteve	7
5. Organizimi i parlamentit	8
6. Formimi i Qeverisë	8
7. Decentralizimi	8
8. Financat dhe ekonomia	9
9. Shteti i së drejtës	10
10. Politika e jashtme dhe integrimet euro-atlantike	10
11. Arsimi	11
12. Shëndetësi	11
13. Kultura, rinia dhe sport	12
14. Feja dhe barazia e plotë e bashkësive fetare	13
15. Familja	13
16. Dukuritë devijante dhe lufta kundër tyre	13
17. Bashkëpunimi me partitë shqiptare në RM e më gjerë	14
18. Ambienti jetësor	14
19. Barazia gjinore	15
20. Politika sociale	15

NDRYSHE



*Konventa Promovuese
20.11.2016, Gostivar*

Hyrje

Kjo platformë zgjedhore paraqet thelbin e ideve programore të LR PDSH, RDK dhe UNITETI për zgjedhjet parlamentare 2016. Në fakt platforma paraqet një opsion serioz për tejkalimin e krizës së thellë politike, socio-ekonomike dhe kulturore në të cilën gjendet vëndi në këto momente të rëndësishme para integritit të plotë në BE dhe NATO.

Aleanca për Shqiptarët e vetëdijshme për sfidat e shumta me të cilat përballen shoqëritë shumëetnike në tranzicion të tejzgjatur socio-ekonomik, përpiket për dhe beson në një modul qeverisës bietik, europian, demokratik dhe social, i cili mund dhe duhet të garantojë një të nesërme më të mirë për gjithë ne. Me këtë, vëndit i hapen mundësitë për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe stabilitet politik.

Aleanca për Shqiptarët është e gatshme të marrë përgjegjësitë dhe obligimet që kërkohen për realizimin e këtyre synimeve të rëndësishme për një shoqëri funksionale dhe demokratike.

Parimet themelore të programit tonë janë:

- *Barazia e plotë e dy komuniteteve më të mëdha këtu*
- *Shteti ligjor*
- *Shteti i mirëqenies sociale*
- *Përzgjedhja e kuadrove qeverisëse sipas standarteve më të mira të meritokracisë*
- *Bashkëpunimi i sinqertë, serioz dhe i gjithanshëm me klasën tonë intelektuale*
- *Parandalimi i largimit të rinisë së shkolluar dhe shqiptarëve në përgjithësi nga vendlindja*

Parë nga ky këndvështrim, Aleanca për Shqiptarët, mbetet e hapur ndaj gjithë aktorëve politikë e jopolitikë, që janë të interesuara dhe punojnë për arritjen e barazisë së plotë kushtetuese juridike të shqiptarëve dhe maqedonasve këtu; që duan zhvillimin e demokracisë së mirëfilltë europiane si dhe një të ardhme të sigurtë euroatlantike të vëndit; Aleanca është e interesuar jetësisht dhe përpiket të arrijë bashkimin e aktorëve të lartpërmendur politikë e jopolitikë. Aleanca për Shqiptarët hedh poshtë me vendosmëri politikat e vjetra meskine, jodemokratike që kanë penguar faktorizimin përfundimtar të shqiptarëve në RM. Aleanca për Shqiptarët punon për një politikë unifikuese kombëtare tej ndarjeve politike, partiake, klanore, rajonale apo tjera këtu.

Aleanca për Shqiptarët konsideron që faktori politik shqiptar këtu nuk ka bërë aq sa duhet dhe nuk ka shfrytëzuar të gjitha hapësirat dhe mundësitë ekzistuese të kësaj demokracie për të realizuar barazinë e plotë nacionale mes shqiptarëve dhe maqedonasve në vënd. Aleanca deklaron solemnisht që rruga dhe mënyra e vetme për realizimin e objektivave të saj politike janë demokratike dhe paqësore.

ALIANCA *për* SHQIPTARËT

PLATFORMA POLITIKE

- 01** Barazi e plotë mes dy bashkësive etnike më të mëdha në vend (Shtet binacional).
- 02** Zyrtarizimi i gjuhës shqipe në nivel të shtetit.
- 03** Marrëveshje që njëri nga tre postet kryesore të shtetit të ju takojë shqiptarëve: Presidenti, Kryetari i Kuvendit apo Kryeministri.
- 04** Zgjedhja e Presidentit të shtetit të bëhet në Kuvend dhe me shumicë të dyfishtë.
- 05** Parlament dy dhomësh.
- 06** Buxheti proporcional me prerje lokale.
- 07** Vetëqeverisje lokale dy shkallëshe në përputhje me kartën europiane.
- 08** Reforma rrënjësore të Sistemit Gjyqësor.
- 09** Integrimet euroatlantike të cilësohen prioritet strategjik dhe të plotësohen kushtet pa vonesa shtesë.
- 10** Luftë ndaj korrupsionit dhe krimit të organizuar.
- 11** Ngritje të standardeve në arsimin dhe kulturën shqiptare në Maqedoni.
- 12** Demonopolizimi i tregut dhe i ekonomisë së vendit.
- 13** Hapje e vendeve të reja të punës përmes forcimit të sektorit privat.
- 14** Sundimi i shtetit të së drejtës.
- 15** Zbatim i rreptë i ligjit ndaj ndotësve masiv të ambientit jetësor.

Kushtetuta

Zhvillimi i deritanishëm i Republikës së Maqedonisë nxori në sipërfaqe dobësitë e aktit më të lartë normativ të shtetit. Kushtetuta e vitit 1991 u shndërrua në katalizator të konflikteve ndëretnike, ndërsa kjo aktualja (kushtetuta e re - e vjetër), e bazuar mbi parimet e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit, mbeti simbol i një akti normativ që nuk pasqyron realitetin objektiv të Republikës së Maqedonisë dhe që çon drejt stagnimit shoqëror dhe joperspektivës.

Zhvillimet politike dhe tjera në dy dekadat e fundit në IRJ të Maqedonisë, vërtetuan krizën serioze dhe mosfunksionimin e sistemit politik dhe ekonomik. Kushtetuta e miratuar në fillimet e pavarësië nga një shumicë etnike dhe nacionaliste maqedonase duke mbivotuar elementin e konsiderueshëm shqiptar, ishte një nga shkaktarët kryesorë të krizës permanente politike dhe tensioneve etnike gjatë gjithë periudhës së post pavarësisë. Përplasjet e armatosura të vitit 2001 si dhe ndryshimi/amendimi i kushtetutës së vjetër nuk çoi drejt një barazie të plotë kushtetuese juridike mes komunitetit maqedonas dhe komunitetit të dytë më të madh këtu, atij shqiptar.

Aleanca për Shqiptarët vlerëson që kushtetuta në fuqi është e mangët, e kufizuar dhe në shumë pjesë të saj nuk përfaqëson realitetet e sotme politike, sociale dhe etnike në vënd. Ndryshimi dhe plotësimi i saj është i dmosdoshëm për të mos thënë urgjencë nacionale.

Aleanca për Shqiptarët mendon që kushtetutat janë të amendueshme dhe të ndryshueshme në pajtim me rrethanat shoqërore dhe politike.

Kushtetutaere, patjetërduhettëreflektojë karakterin shumë etnik dhe shumkulturore të shoqërisë dhe shtetit të Maqedonisë, tolerancën dhe bashkëjetesën. Kushtetuta, gjithashtu duhet të paraqes një kornizë të qëndrueshme normative që do mundësojë përpilimin e ligjeve në përputhje të plotë

me standardet evropiane.

Në këtë drejtim, Aleanca për Shqiptarët konsideron që një kushtetutë e re demokratike duhet të definojë vëndin si shtet i barabartë i dy komuniteteve më të mëdha këtu, me të drejta të garantuara për pakicat e vogla etnike apo tjera.

Marrëveshja e Ohrit

Sipas nesh, MO është një dokument i rëndësishëm që ndërpreu konfliktin e vitit 2001 duke u dhënë komuniteteve dhe shoqërisë mundësinë për ndërtimin e një shoqërie të avancuar demokratike.

Aleanca për Shqiptarët vlerëson MO në pjesën hyrëse ku në mënyrë të përpiktë thuhet: "Një shtet bashkëkohor demokratik në rrjedhën natyrore të zhvillimit dhe krijimit të vet, duhet vazhdimisht të sigurojë Kushtetutën e tij që tërësisht t'i plotësojë nevojat e të gjithë qytetarëve të tij në pajtim me standardet më të larta ndërkombëtare, si edhe standardet që vet do të zhvillohen vazhdimisht".

Sipas formulimit të mësipërm dhe në bazë të MO, kushtetuta aktuale nuk duhet parë si finale, por si një akt juridik që kërkon ndryshime dhe plotësime të shumta në përputhje me rrethanat politike dhe tjera këtu.

Ndarja e pushteteve

Aleanca për Shqiptarët angazhohet për një ndarje të mirëfilltë të pushteteve, ndarje që nënkupton balancim dhe kontroll të ndërsjellë. Për Aleancën, e një rëndësie të veçantë është depolitizimi i gjyqësorit, depolitizimi i organeve të ndjekjes dhe organeve administrative në tërësi. Profesionalizimi dhe meritokracia duhet të jenë bazë e funksionimit të organeve në fjalë.

Organizimi i parlamentit

Aleanca për Shqiptarët angazhohet për Parlament dydhomësh: Dhomën e bashkësive etnike dhe Dhomën e përfaqësuesve.

- *Parlamenti duhet të shndërrohet në qendër të vendimmarrjeve politike dhe shprehjes së vullnetit gjithëpopullor.*
- *Duhet të jetë pasqyrim besnik dhe i realtë i forcës demografike të komuniteteve që jetojnë këtu.*
- *Dhoma e bashkësive etnike duhet të reflektojë barazinë e komuniteteve etnike.*
- *Parlamenti republikan duhet të jetë vënd i ballafaqimit të lirë e të drejtë të ideve politike ku përfaqësuesit politikë kanë të drejtën e vetos për të gjitha çështjet me karakter etnik apo tjetër.*
- *Dy dhomat e Parlamentit të jenë plotësisht të barabarta. Në rast mos-pajtueshmërie për çështje të caktuara, të formohet një komision i përbashkët i cili detyrimisht duhet të gjejë një zgjidhje të kapshme për të dyja dhomat.*

Formimi i Qeverisë

Nisur nga eksperiencia e gjertanishme e keqpërdorimit dhe zhvlerësimit nga partitë politike të votës komunitare shqiptare këtu, Aleanca për Shqiptarët deklaroi që do të jetë garant i mbrojtjes së çdo vote të lirë shqiptare këtu.

Pjesëmarja në qeveri varet dhe kushtëzohet nga një marrëveshje e panegociueshme paraprake mes fituesve të zgjedhjeve të lira nga dy komunitetet më të mëdha etnike këtu.

Aleanca për Shqiptarët deklaroi publikisht dhe solemnisht, që nuk do të jetë pjesë e asnjë qeverisjeje në të ardhmen pa përfshirjen e plotë të programit të saj

elektoral në programin e qeverisë të dalë nga zgjedhjet vijuese.

Negociatat drejt finalizimit të marrëveshjes qeverisëse do të jenë transparente për publikun shqiptar dhe më gjerë. Asnjë marrëveshje nuk mund të nënshkruhet në një format sekretiv dhe pa informimin e drejtë dhe në kohë të trupit votues dhe përgjithësisht popullsisë shqiptare.

Decentralizimi

Aleanca për Shqiptarët mendon se një përqendrim i tepërt i pushtetit në organet qendrore është i dëmshëm, si për shtetin, ashtu dhe për qytetarët e tij, pa dallim përkatësie etnike e fetare.

Sipas Aleancës, decentralizimi duhet të shprehet përmes regjioneve dhe avancimit të statusit të njësive të qeverisjes lokale.

Ne mendojmë që procesi decentralizues mund të realizohet me anë të ndarjeve rajonale si dhe avancimit të statusit të njësive të vetëqeverisjes lokale.

Aleanca për Shqiptarët do të krijojë një klimë afirmative që njësitë e qeverisjes lokale të kuptohen si njësi administrative që ndërlihen me nevojat jetike të qytetarëve në kuptimin "demos" të fjalës, e jo të kuptohen si njësi që afirmojnë të drejtat nacionale të etniteteve jo shumicë.

Në këtë drejtim, ASH do inicojë organizimin e ri territorial të vëndit, sipas të cilit, faktori i reformuar dhe modern administrativ do të prevalojë atë aktualin politik partiak.

Ndarja e re territoriale do të ndërtojë një tip të ri të njësive të administrimit lokal, si njësi funksionale në të gjitha aspektet, madje edhe në atë financiar sepse do të gjenerojë mjete të mjaftueshme për një funksionim relativisht të pavarur.

ASH, do të angazhohet me gjithë kapacitetin e saj njerëzor për fuqizimin e njësive të vetëqeverisjes lokale me anë të

zgjërimit dhe shtimit të kompetencave të tyre. Gjithë kjo në funksion të menaxhimit më të mirë dhe efikas me burimet natyrore e tjera që ndodhen brenda kufive të tyre administrative.

Ligji i ri për decentralizimin e pushtetit të parashohë vendimarrje të plotë të njësive të v.v lokale në sektorin e rëndësishëm të punëve të brendshme, si çështje me peshë dhe sensibil për interesat dhe sigurinë e komuniteteve lokale.

Financat dhe ekonomia

Është i prekshëm dhe i konsiderueshëm hendeku i thellë në zhvillimin e përgjithshëm socio-ekonomik mes dy komuniteteve më të mëdha në vënd; kjo vjen si rezultat i pabarëzisë në shpërndarjen dhe diskriminimit të dukshëm në shfrytëzimin e financave publike; është i dukshëm monopolizimi i investimeve buxhetore nga elitat politike të maqedonasvet etnikë; komuniteti shqiptar është i marginalizuar në çdo drejtim kurse vendbanimet me shumicë shqiptare të popullsisë pranojnë pak ose aspak investime të drejtpërdrejta nga buxheti shtetëror; jeta institucionale është uzurpuar nga shumica relative e cila shfrytëzon maksimalisht në dëm të komunitetit tjetër në fusha të rëndësishme, si buxheti, investimet e brendshme dhe të jashtme, punësimi i forcës punëtore, avancimet profesionale apo tjera, edukimi dhe arsimit si dhe politikatat e rëndësishme sociale.

Edhe pas Marrëveshjes së Ohrit që u pa si dokument shpresëdhënës për kohën, në Republikën e Maqedonisë vazhdon diskriminimi i planifikuar ekonomik ndaj shqiptarëve.

Bazuar në matjen e të hyrave publike sipas qasjes së harxhimeve në strukturën e konsumit nacional, shqiptarët kontribuojnë me mbi 30% në shumën e përgjithshme e të hyrave buxhetore si dhe rritjen e rezervave devizore me mbi 30% që grumbullohen

nga remitancat e mërgatës shqiptare që jetojnë dhe punojnë në botën e jashtme. Edhe pse shqiptarët kanë një kontribut të konsiderueshëm në të hyrat e përgjithshme buxhetore dhe në rritjen e rezervave devizore, ku si rrjedhojë ata kontribuojnë në ruajtjen e stabilitetit makroekonomik, si parakusht themelor të funksionimit normal të procesit ekonomik, ata në vazhdimësi janë diskriminuar si në aspekt ekonomik po ashtu edhe në aspektin financiar nga një qeverisje e kontrolluar tërësisht nga nacionalistë maqedonas. Thelbi i procesit të decentralizimit është që vendimet për plotësimin e nevojave kolektive sa më shumë ti përshtaten preferencave të



konsumatorëve, dhe për këtë, më tepër tu ofrohen atyre që kanë nevojë për to.

Që këto vendime të jenë të realizueshme kërkohet edhe burime adekuate të financimit. Niveli aktual i të hyrave të pushtetit lokal është 6.5 % të GDP-së, që është dyfish më pak se mesatarja e të hyrave të pushtetit lokal në vendet e UE-së.

Aleanca zotohet të dyfishojë këto shifra brenda mandatit të parë qeverisës.

Aleanca për Shqiptarët do të angazhohet për eliminimin e diskriminimit të planifikuar ekonomik të shqiptarëve dhe vendosjen e mekanizmit institucional të barazisë në ndarjen e mjeteve buxhetore.

Kjo do vlejë si për harxhimet korrekte ashtu edhe për ato kapitale.

Strategjia në fjalë do realizohet nëpërmjet miratimit të një Ligji të ri sipas të cilit do vendoset mekanizmi institucional për përpilimin dhe miratimin e buxhetit shtetëror. Kjo do bëjë që 30 % e mjeteve buxhetore të shkojnë për nevojat e komunitetit shqiptar, me % e mbetur të alokuar për pjesën tjetër të vëndit.

Aleanca për Shqiptarët, si pjesë të programit të vet ekonomik ka paraparë një shpërndarje të drejtë, të barbartë dhe proporcionale të mjeteve buxhetore, me ç'rast brenda disa vitesh do të arrihej përmirësimi i gjendjes ekonomike dhe sociale të komunitetit shqiptar.

Shteti i së drejtës

Aleanca për Shqiptarët vlerëson se funksionimi i shtetit ligjor është element kyç për demokratizimit të një shoqërie. Shteti ligjor, që nënkupton barazi të plotë të shtetasve dhe grupeve etnike para ligjit, është mekanizmi i vetëm që garanton shoqëri efikase dhe funksionale. Shteti ligjor disponon mekanizma të nevojshëm për ndërtimin e kapaciteteve demokratike

aq të nevojshme për Maqedoninë në këta momente.

Aleanca për Shqiptarët do ti luftojë të gjitha llojet e stereotipeve që paraqiten si rrjedhojë e sundimit arbitrar të së drejtës, në ç'rast e drejta identifikohet me "diktaturën e shumicës". Ky koalicion nuk do lejojë që e drejta të shndërrohet në pronë të një etnie. Tolerancën dhe konsensusin, Aleanca do t'i vendos në epiqendër të proceseve politikbërëse, duke krijuar kushte optimale për sundim të së drejtës dhe funksionim efikas të shtetit ligjor.

Politika e jashtme dhe integrimet euro-atlantike

Përmes politikës së jashtme, Aleanca ka për qëllim të sigurojë një pozitë më të favorshme të vendit në marrëdhëniet ndërkombëtare, duke promovuar zhvillim të qëndrueshëm, interesa politike, ekonomike, kulturore dhe ato të sigurisë.

Politika e jashtme do bazohet në parimet e paqes, barazisë, marrëdhëniet e mira fqinjësore, rritjen e bashkëpunimit rajonal, multilateralizmin aktiv dhe respektimin e plotë të së drejtës ndërkombëtare. Politika e jashtme e Aleancës për Shqiptarët do të konceptohet bazohet kryesisht në këto sfera: bashkëpunimi rajonal, tërheqja e investimeve të huaja, mbështetja e komunitetit të biznesit vendor në paraqitjen e tyre në tregun ndërkombëtar, si dhe mbrojtja e interesave të qytetarëve tanë nëpër botë.



Po ashtu, Aleanca do të vazhdojë të punojë në zhvillimin e marrëdhënieve miqësore me vendet e tjera, për intensifikimin e bashkëpunimit ekonomik me inkurajimin e investimeve në vendin tonë dhe forcimin e marrëdhënieve tregtare.

Arsimi

Aleanca për Shqiptarët, për të arritur standardizim, modernizim dhe efikasitet evropian në proces të arsimit, ka hartuar strategji reformuese afat mesme dhe afatgjate.

Kjo strategji do të bazohet në tre aspekte shtyllat kryesore të zhvillimit të sistemeve arsimore dhe atë: aspekti funksional, strukturor dhe institucional.



Në këtë kuptim, Aleanca për Shqiptarët do të ndër marrë një sërë aktiviteteve reformash që do t'i mbërthejnë të gjitha nivelet e arsimit. Që do përfshijnë të gjitha nivelet e sistemit arsimor këtu.

Riorganizimi i rrjetit të shkollave bazuar në reformat bashkëkohore të sistemeve shkollore si dhe një vëmendje të veçantë Aleanca do t'i kushtojë Arsimit universitar.

Reformat në arsimin e mesëm duhet të orientohet kah profesionalizimi i arsimit që do të jetë një baze e fortë për krijimin e një fuqie punëtore të specializuar dhe mirë të përgatitur për sektorë të caktuara të ekonomisë që do të jetë në përputhje me kërkesat e tregut të dijes.

Do angazhohet për departizimin dhe depolitizimin e plotë të arsimit në të gjitha nivelet, ndërsa universiteteve do t'u a kthejë autonominë në tërësi. Do ta rishqyrtojmë arsyeshmërinë për dislokimin e degëve të universiteteve dhe do ta përmirësojmë pozitën materiale të institucioneve arsimore - shkencore në përgjithësi. Do ta rishqyrtojmë modelin e studimeve sipas Kartës së Bolonjës, duke ia përshtatur atë specifikave dhe kushteve të vendit, gjithsesi duke i dhënë përparësi aspektit shkencor hulumtues. Do të angazhohet edhe për ligje cilësore e të qëndrueshme që kanë të bëjnë me sferën e arsimit të të gjitha fazave, niveleve, me të cilat do zëvendësohen disa ligje aktuale që arsimin dhe arsimtarin mësimdhënës i kanë devaluuar tërësisht

Shëndetësi

Aleanca për Shqiptarët është e vetëdijshme për gjendjen e rëndë në shëndetësinë shqiptare në vënd. Vërehet një diskrepancë e madhe në ndarjen e mjeteve buxhetore për institucionet shëndetësore në perëndim të vëndit. Këto spitale nuk janë të furnizuara me pajisje të nevojshme për kujdesin shëndetësor të popullsisë. Numri i mjekëve për kokë banori në pjesët perëndimore të vëndit është shumë më i ulët se në zonat tjera. Vërehet një diskriminim i vazhdueshëm i kuadrit shqiptar gjtë procedurave përzgjedhëse për specializime në degë të caktuara të shëndetësisë. Ne garantojmë që ky kaos në shëndetësinë tonë do marrë fund brenda mandatit të parë qeverisës.

Aleanca për Shqiptarët pas shumë analizave ka ardhur në përfundim se institucionet shëndetësore në Maqedoni

(Ministria e shëndetësisë, Fondi i shëndetësisë, Oda e mjekëve dhe mjekët e bashkëpunëtorët mjekësorë) nuk zhvillojnë aktivitete të koordinuara, gjë që e dëmton funksionimin e shëndetësisë në përgjithësi. E gjithë kjo, sipas Aleancës, ka shkaktuar një kaos të vërtetë, duke krijuar pengesa artificiale ndërmjet mjekëve dhe pacientëve, që si rrjedhojë ka zvogëlimin e nivelit të besueshmërisë në relacionet pacient- mjek. Aleanca vlerëson se këta raporte të krijuara artificialisht ndikuan përfundimisht në dështimin reformave të paralajmëruara me aq pompozitet nga strukturat qeverisëse. Për Aleancën, kthimi i dinjitetit të pacientit dhe familjes së tij do të jetë në qendër të vëmendjes. Aleanca do të korrigjojë mënyrën e shpërblimit të punës së mjekut dhe punëtorëve tjerë shëndetësorë për një motivim më të fuqishëm që të vazhdojnë me punën e tyre profesionale në vend, e jo të mendojnë vazhdimisht se ardhmëri më të lumtur do të gjejnë në vendet më të zhvilluara evropiane. Edhe për sa i përket shëndetësisë, Aleanca vlerëson se profesionalizmi gjithashtu duhet të zë vendin kryesor, e jo njerëzit partiakë e me cilësi të dyshimta profesionale.

Angazhimi i menaxherëve vetëm se kanë librezat partiake dhe synimi i tyre për të shfrytëzuar fondet shëndetësore për qëllime personale grupore e partiake, duke lënë spitalet publike në mëshirë të buxheteve paushale dhe çmimoreve degraduese që datojnë nga ish-Jugosllavia, për Aleancën është i papranueshëm. Kjo Aleancë do të angazhohet për hartim të buxheteve sipas shërbimeve që i ofrojnë spitalet publike dhe do t'i korrigjojë buxhetet kriminale që u jepen për shërbime paralele spitaleve private të afërta me partitë politike.

Aleanca do të ndërtojë mekanizma efikas për kthimin e dinjitetit të Odës së Mjekëve të Maqedonisë, që është organizatë e pavarur profesionale e doktorëve të mjekësisë së bashkuar, për mbrojtjen dhe përparimin e profesionalizmit, detyrimeve dhe të drejtave etike, për përmirësimin

e cilësisë së mbrojtjes shëndetësore, për monitorimin e marrëdhënies së punëtorëve shëndetësorë ndaj shoqërisë dhe qytetarëve, si dhe për mbrojtjen e interesave të profesionit mjekësor. Vetëm me një nivel të këtillë përgjegjesie, Aleanca da mund ta kthejë shkëlqimin e humbur të kësaj Shoqate.

Kultura, rinia dhe sport

Aleanca për Shqiptarët në programin e saj i jep një rëndësi të veçantë zhvillimit dhe mbrojtjes së kulturës materiale dhe shpirtërore të komunitetit tonë këtu. Aleanca është e mendimit që kultura jonë kombëtare është në gjendje të rëndë si pasojë e mosfinancimit në nivelet e duhura nga buxheti shtetëror si dhe mangësive të natyrave tjera.



Në këtë kuptim një vëmendje të veçantë do ti kushton gjuhës si komponent bazë e çdo kulture. Barazia e plotë e gjuhës shqipe e rregulluar me ligj e kushtetutë

mbetet prioritet numër një i Aleancës për Shqiptarët.

Aleanca për Shqiptarët do të luftojë me vendosmëri dhe fuqishëm iniciativat etnocentrike të qarqeve të caktuara dhe do jetë gjithnjë në mbrojtje të kulturës shqiptarë, gjithnjë duke respektuar dhe vlerësuar kulturat tjera të cilat i sheh si pjesë përbërëse të hapësirës sonë të përbashkët shumëetnike.

Aleanca do të angazhohet për mbrojtjen e revitalizimin e trashëgimisë kulturore dhe shpirtërore të shqiptarëve të Maqedonisë.

Feja dhe barazia e plotë e bashkësive fetare

Aleanca për Shqiptarët është e vetëdijshme për rolin pozitiv dhe të rëndësishëm që komunitetet religjioze kanë për të luajtur në shoqëri. Aleanca për Shqiptarët respekton bindjet personale religjioze të gjithsecilit duke i parë ato si vlera pozitive në shoqëri. Aleanca për Shqiptarët do të përpiqet për barazinë e plotë të komunitetve religjioze para ligjit. Një ligj i ri për komunitetet religjioze i bazuar në modelet më të mira të demokracive të avancuara perëndimore do të jetë synim yni afatshkurtër në këtë sferë të rëndësishme shoqërore.

Familja

Aleanca për Shqiptarët preokupim parësor e ka edhe caktimin e vendit të familjes shqiptare në sistemin më të gjerë shoqëror. Aleanca si organizim politik, vlerëson se duhet ta japë kontributin e saj në drejtim të mbrojtjes së vlerave tradicionale të familjes.

Në këtë kuptim, Aleanca për Shqiptarët do të angazhohet në kultivimin e vlerave të familjes, duke i respektuar ato në çdo aspekt, por që vlen vetëm për familjet me

originë nga bashkëshortësitë e lidhura mes dy personave të moshës madhore të gjinive të kundërta.



Duke e marrë parasysh këtë, Aleanca për Shqiptarët do të përkujdeset në veçanti për familjet me një ose pa prindër të fëmijëve, familjet me anëtarë me nevoja të posaçme, familje me fëmijë të birësuar, familjet me probleme financiare-materiale dhe çiftet e rinj bashkëshortor të cilët për shkak të kushteve që i imponon zhvillimi bashkëkohor i shoqërisë, vështirë përcaktohen për lindje të fëmijëve. Aleanca për Shqiptarët do të krijojë kushte që familja të jetë në gjendje që në mënyrë të pavarur të marrë vendime dhe të ketë më shumë zgjidhje në aspektin e punësimit, strehimit, ngritjes profesionale, edukimit arsimimit të fëmijëve etj.

Dukuritë devijante dhe lufta kundër tyre

Aleanca për Shqiptarët do t'i luftojë me tërë potencialin e vet dukuritë devijante në shoqëri e sidomos në atë shqiptare në Maqedoni. Ajo do t'i shpallë luftë të pa kompromis narkomanisë, alkoolizmit, prostitucionit, lojërave të fatit dhe të gjitha tipave të kriminalitetit. Andaj, Aleanca do të vihet plotësisht në shërbim të ndërtimit të mekanizmave të kontrollit social, që i rregullojnë sjelljet e individëve dhe grupeve në shoqëri. Aleanca e potencon këtë luftë, e bindur se shoqëria shqiptare në Maqedoni, kohëve të fundit ballafaqohet me probleme serioze të kësaj natyre.

Bashkëpunimi me partitë shqiptare në RM e më gjerë

Aleanca për Shqiptarët është e bindur që pa një bashkëpunim transparent, serioz dhe permanent të të gjithë aktorëve e faktorëve politikë e jopolitikë shqiptarë këtu, nuk arrihet deri tek zgjidhja e çështjeve madhore me të cilat përballen shqiptarët në IRJM.

Aleanca për Shqiptarët është e hapur për bashkëpunim me të gjitha partitë politike të shqiptarëve në Maqedoni dhe më gjerë. Ajo do t'i luftojë të gjitha përçarjet dhe përçarësit që veprojnë jashtë logjikës politike, e që e ngadalësojnë avancimin e statusit të shqiptarëve në RM.

Aleanca është e vetëdijshme se pa një konsensus brenda shqiptar, është i pamundshëm konsensusi brenda shtetit dhe shoqërisë, prandaj ajo i inkurajon të gjitha partitë shqiptare në Maqedoni që urgjentisht të ndërmarrin aktivitete politike për ndërtimin e një strategjie substanciale kombëtare, pa të cilën asnjë subjekt shqiptar në mënyrë vetanake nuk mundet t'i lëvizë çështjet me rëndësi të veçanta për këtë pjesë të kombit. Strategjia substanciale ose themelore për çështje kaq të rëndësishme kombëtare, në asnjë mënyrë nuk i dëmton të tjerët, e aq më pak ambiciet individuale e grupe brenda organizimit politik të shqiptarëve në Maqedoni.

Aleanca vlerëson që të ndërtohet strategjia minimale kombëtare për shqiptarët në Maqedoni, bashkëpunimi me partitë shqiptare jashtë Maqedonisë është gjithashtu i domosdoshëm. Në frymën e kësaj, Aleanca do të përgatisë një Memorandum, për rëndësinë dhe qëllimet e të cilit do t'i njoftojë partitë relevante në Shqipëri, Kosovë, Mal të Zi dhe Luginë të Preshevës. Vetëm me ndihmën e partive simotra jashtë Maqedonisë dhe përkrahjen e personaliteteve të verifikuara brenda vendit, çështja shqiptare në Maqedoni mundet të lëvizë përpara. Aleanca për

Shqiptarët është e vetëdijshme për vështirësitë në të cilat do të hasë.

Ambienti jetësor

Aleanca për Shqiptarët është e shqetësuar për cilësinë e mjedisit jetësor në trevat e banaura nga një shumicë etnike shqiptare këtu. Ne mendojmë që ndotja e ajrit dhe degradimi i hapësirës publike është e lidhur ngushtësisht sa me cilësinë e qeverisjes lokale aq edhe me politikat e qeverisjeve të ndryshme qendrore që nuk duket të kenë ndjeshmërinë e njëjtë ndaj degradimit human dhe ekologjik për pjesë të caktuara të territorit republikan.



Aleanca për Shqiptarët e ndjek me kujdes gjendjen rreth ndotjes së ajrit, sidomos në vendbanimet e banuara me shqiptare, prandaj preokupim parësor i saj do të jetë ndërmarrja e të gjitha aktiviteteve për vënien e gjendjes nën kontroll dhe tejkalimin e kësaj situatë që lë pasojë

afatgjate mbi popullatën e vendbanimeve me ndotje ekstreme të ambientit jetësor. Aleanca do t'i inkurajojë të gjitha Shoqatat ambientaliste, duke ndërtuar me to raporte partneriteti, në drejtim të ndërtimit të një ambienti të shëndosh jetësor.

Aleanca për Shqiptarët do të angazhohet që zhvillimi të jetë në përputhje me konventat evropiane për sa i përket energjisë së ripërtirëse, e cila e kap 20% e energjisë së përgjithshme duke mos e prishur eko-sistemin.

Barazia gjinore

Aleanca për Shqiptarët do të angazhohet për trajtim plotësisht të barabartë të femrës në shoqëri. Duke qenë të vetëdijshëm se roli i femrës shqiptare bëhet gjithnjë e më i madh, në familje dhe shoqëri, do të krijojmë plane konkrete, për projekte që do ishin në interes të avancimit të të drejtave të gjinisë femërore e veçmas të grave shqiptare meqë krahasuar me ato të bashkësisë etnike maqedonase, ato ende qëndrojnë shumë larg pozitës që mund ta kenë në familje dhe shoqëri.



Meqë niveli i qytetërimit të një kombi varet nga ngritja e gjithanshme e botës femërore, Aleanca për Shqiptarët duhet të investojë shumë në ngritjen e saj përmes

shkollimit, trajnimeve të ndryshme për rikualifikime, punësimit dhe përfshirjes aktive në jetën politike dhe në organe të natyrave të ndryshme vendimmarrëse në shoqëri dhe shtet.

Aleanca për Shqiptarët do të përkujdeset edhe për të drejtat tjera të femrës, siç është e drejta e barabartë në familje, e drejta në pronë, lufta kundër dhunës në familje, e drejta e pushimit të lindjes, e drejta për mbrojtje shëndetësore gjatë shtatzënisë dhe lehonisë, stimulimi material pas fëmijës së tretë etj.

Politika sociale

Politikat sociale do jenë në qendër të vëmendjes të programit tonë zgjedhor. Komuniteti shqiptar këtu, duke qenë përjashtuar historikisht nga strukturat shtetërore dhe ekonomike, e ka vuajtur më shumë se tjerët tranzicionin e stërzgatur socio ekonomik të dy dekadave të fundit. Andaj një politikë gjithëpërfshirëse sociale për pjesën shqiptare të vendit do përpilohet dhe implementohet që në muajt e parë qeverisës.

Aleanca për Shqiptarët, kujdesin për nevojat dhe problemet e personave me aftësi të kufizuara do ta ketë një nga prioritetet që t'u mundësojë jetë të dinjitetshme dhe të merituar. Aleanca për shqiptarët do angazhohet në ngritjen e vetëdijes publike, përmes motivimit të institucioneve përkatëse, për t'u kujdesur për këtë kategori që janë barrë për familjen dhe shoqërinë.

Aleanca për Shqiptarët do kujdeset për përmirësimin e infrastrukturës, për t'i lehtësuar kësaj kategorie lëvizje sa më të sigurtë siç janë: Sinjalizimi special në semaforë, shtigje për këmbësorë, udhëkryqe dhe shtigje speciale për ngjitje në pjerrtësi, ashensorë, si dhe lehtësime në mjedise tjera, nga çerdhet, në shkolla dhe në vendet e punës, që sadopak ky komunitet të ndjehet më i sigurtë për një jetë më

dinjitoze. Për tërë këtë përkujdesje, që nga familja, pushteti lokal dhe ai qendror, janë të nevojshme mjete materiale, prandaj për këto projekte njerëzore dhe shoqërore duhet siguruar buxhet të qëndrueshëm që do ndahet në mënyrë të barabartë në tërë vendin dhe për të gjithë komunitetet etnike.

Është mëse e nevojshme edhe përkujdesja e personave me moshë të madhe, prandaj Aleanca për Shqiptarët do angazhohet për themelimin e Institucioneve specialiste (Shtëpi të pleqve), ku nën kujdesie të plotë kjo kategori e shtresës shoqërore, do mund të kalonte një pjesë të jetës. Deri tani edhe në këtë drejtim është bërë padrejtësi, nga vet fakti se në asnjë rajon të banuar me shqiptarë nuk janë ngritur institucione të këtilla.

Aleanca për Shqiptarët do angazhohet për ndihmë të qëndrueshme sociale dhe përkujdesje që këto ndihma mos të keqpërdoren, por të ndahen në mënyrë dhe objektive.

**ALEANCA** për SHQIPTARËT

VOTO
NUMRIN



NDRY SHE